

# ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGJISE

## PJESA I

### Metodologjia e llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike.

#### HYRJE

Metodologjia e llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike hartohet si rezultat i krijimit te OST sh.a. me VKM nr.797 dt. 4.12.2003 “Per krijimin e shoqerise Operatori i Sistemit te Transmetimit” dhe ne zbatim te nenit 28 pika 1 te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”. Kjo metodologji ka per qellim vendosjen e tarifave te transmetimit mbi bazen e parimeve te llogaritjes se ketyre tarifave duke vleresuar te dhenat e domosdoshme per nje tarife te drejte.

Metodologjia eshte konceptuar e ndare ne tre pjese :

- Metodologjia e llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike.
- Tabelat me te dhenat teknike dhe ekonomiko financiare
- Metodologjia e llogaritjes se tarifave per sherbimet ndihmese.

#### 1. Termat e perdorur ne metodologji

- 1.1 **Faktori i axhustimit vjetor** – nje perqindje e barabarte me faktorin e inflacionit minus faktorin e permiresimit te eficences.
- 1.2 **Tarifa mesatare e transmetimit** – e ardhura mesatare per kWh e reflektuar ne faturat e klienteve te sistemit te transmetimit per nje periudhe 12 mujore, e llogaritur si e ardhura totale nga pagesat qe lidhen me kapacitetin, pagesat qe lidhen me energjine dhe pagesat mujore fikse pjestuar me kWh total te livruara nga sistemi i transmetimit ne kompanite e shperndarjes dhe perdoruesit e kualifikuar te energjise elektrike qe ndodhen ne Shqiperi.
- 1.3 **Tarifa mesatare tavan e transmetimit** – niveli maksimal i lejueshem i tarifes mesatare te transmetimit per nje periudhe specifike 12 mujore.
- 1.4 **Tarifat baze** – paketa e vlerave te tarifave te sherbimit te transmetimit e percaktuar sipas kostove ne vitin baze.

- 1.5 **Viti baze** – viti i pare i ciklit te vleresimit te tarifave, qe i korrespondon nje periudhe 12 mujore gjate se ciles tarifate e transmetimit te miratuara nga ERE-ja aplikohen ne faturat e klienteve. Fillimi i vitit baze eshte data ne te cilen kosto e sherbimit te transmetimit i ngarkohet klienteve te sistemit te transmetimit sipas tarifave te reja te transmetimit. Kjo date mund te jete jo me shume se 30 dite para dhe jo me shume se 30 dite pas dates se miratimit zyrtar te tarifave te reja te transmetimit.
- 1.6 **Tarifate e diferencuara** – tarifate per sherbimet e klienteve qe perfshijne pagesat qe lidhen me kapacitetin, pagesat qe lidhen me energjine, pagesat mujore fikse dhe pagesat per energjine reaktive.
- 1.7 **Sistemi i shperndarjes** – Sistemi i Shperndarjes perfshin gjithe elementet ne nivelet e tensionit  $\leq 110\text{kV}$ , te cilat zoterohen nga Kompanite Shperndarese.
- 1.8 **Faktori i permiresimit te eficences (faktori X)** – perqindja vjetore e reduktimit ne koston e sherbimit te transmetimit qe rezulton nga permiresimet ne eficencen e prodhimit dhe permiresimet ne teknologji.
- 1.9 **Konsumi i energjise elektrike per qellime teknologjike** – konsumi i forces reaktore, konsumi i kompensatorit sinkronizues, konsumi i baterise se kondensimit dhe energjia qe konsumohet nga OST-ja per perdorimin e vet dhe qe merret direkt nga nenstacionet e transformimit dhe facilitetet ne pronesi te sistemit te transmetimit. Humbjet ne rrjet perjashtohen. Energjia e konsumuar nga stacionet gjeneruese perjashtohet.
- 1.10 **Matesi i energjise elektrike** – nje mekanizem per matjen e fluksit te energjise aktive dhe reaktive dhe energjise brenda rrjetit te transmetimit ose matja e fluksit te energjise elektrike aktive dhe reaktive dhe energjise permes kufijve nderkombetare ose matja e energjise elektrike aktive dhe energjise elektrike te livruar tek klientet e sistemit te transmetimit.
- 1.11 **Furnizimi me energji elektrike** – aktiviteti i marketingut te energjise elektrike qe konsiston ne blerjen e energjise elektrike nga prodhuesit dhe shitja e energjise elektrike te perdoruesit si dhe blerja dhe shitja e energjise elektrike ne nje treg te momentit (spot) ose treg shkembimi.

- 1.12 **Klienti i kualifikuar** – Nje konsumator i Energjise Elektrike qe ka te drejte sipas Legjislacionit ne fuqi ose rregulloreve te miratuara nga ERE, te zgjedhe Furnizuesin e Energjise Elektrike per Energjine Elektrike te perdorur per nevojat e tij
- 1.13 **Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike** –Institucion shteteror qe rregullon aktivitetin e sektorit te energjise elektrike sipas Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike.
- 1.14 **Kodi i Rrjetit** – Kodi i Sistemit te Transmetimit eshte nje dokument qe percakton kufijte, mardheniet ndermjet OST sh.a. dhe Perdoruesve dhe vendos procedurat per operimin, planifikimin, lidhjet dhe zhvillimin e Sistemit te Transmetimit ne perputhje me zhvillimin e Tregut Shqiptar dhe Rajonal te Energjise Elektrike. Ai permbledh informacionin e kerkuar dhe procedurat qeverisese te mardhenieve ndermjet OST sh.a. dhe Perdoruesve te Sistemit te Transmetimit.
- 1.15 **Prodhuesit e pavarur te energjise elektrike** – Gjeneruesit e Energjise Elektrike qe marrin pjese nen pergjegjesine e vetvetes, te ndare nga Sistemi Elektroenergjetik, per te mbuluar nevojat per Energji Elektrike, te vetat, ose te konsumatoreve te veçante, apo shesin Energji Elektrike ne Sistemin Elektroenergjetik.
- 1.16 **Humbjet ne rrjet** – Diferenca mes sasise se energjise elektrike te livruar ne rrjetin e energjise elektrike dhe sasise se energjise elektrike te terhequr nga rrjeti i energjise elektrike gjate periudhes kohore respektive.
- 1.17 **Aseti Baze i Rregulluar (RAB)** vlere e aseteve fikse ne pronesi te OST-se qe perdoren per te siguruar sherbim per klientet e transmetimit dhe per te plotesuar detyrimin e OST-se per te siguruar qendrushmerine dhe sigurine e sistemit elektrik. Asetet baze te rregulluara nuk perfshijne investimet financiare, letrat me vlere, llogarite per t’u marre ose parate cash.
- 1.18 **Cikli i shqyrtimit te tarifave** – Periudha per te cilen tarifat e reja hyjne ne fuqi dhe rregullohen sipas vendimit te marre nga Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike, pas nje shqyrtim te plote dhe te detajuar te aplikimit te tarifave te paraqitura nga operatori i sistemit te transmetimit.

- 1.19 **Sistemi i transmetimit** – Sistemi i Transmetimit te Energjise Elektrike perbehet nga bashkesi linjash elektrike te tensionit te larte (110kV, 150kV, 220kV, 400kV), nenstacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i te cilave perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Çdo aset qe perfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, sherbimet ndihmese, truallin, ndertesat dhe asete te tjera ndihmese, elektrike ose jo, te cilat nevojiten per funksionimin e duhur te instalimeve te veçanta te Sistemit te Transmetimit, jane elemente perberese te Sistemit te Transmetimit.
- 1.20 **Klientet e sistemit te transmetimit (perdoruesit)**– Persona fizik dhe juridik qe kryejne veprimtari te licensuara ne Sistemin Elektroenergjetik si Prodhuesit (Gjeneruesit), Shperndaresit (Kompanite Shperndarese), Konsumatorët e Kualifikuar, Furnizuesit, si dhe çdo person Juridik qe perfiton nga Sherbimet e Transmetimit
- 1.21 **Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST)** – Nje kompani qe zoteron dhe operon sistemin e transmetimit dhe garanton sigurine e furnizimit me energji elektrike. OST-ja eshte nje person juridik qe i eshte dhene nje licence per transmetimin e energjise elektrike.
- 1.22 **Perdoruesi i energjise elektrike** – Nje person apo subjekt juridik qe blen Energji Elektrike per te konsumuar per vetveten apo per procese te ndryshme qe ka ne aktivitetin e tij.

## 2. Rregullat e pergjithshme dhe parimet baze

- 2.1 Kjo metodologji eshte hartuar ne zbatim te Ligjit Nr 9072 dt. 22.5.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, si dhe te akteve te tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- 2.2 Gjithe burimet e te ardhurave te OST-se te percaktuara ne kete metodologji tarifash paguhen nga klientet (perdoruesit) e sistemit te transmetimit.
- 2.3 Kompanite e shperndarjes nuk duhet t’i paguajne pagesa lidhje OST-se. Kosto e OST-se per nje lidhje te re me rrjetin e shperndarjes duhet shlyer nepermjet tarifes se transmetimit dhe te “shperndahet” tek te gjithe klientet ne Shqiperi. Nje klient qe ka nevojë per nje lidhje te re me rrjetin e shperndarjes do t’i paguaje nje pagese lidhje kompanise se shperndarjes,

por kjo pagese nuk ka lidhje me kostot e OST-se per te mundesuar qe rrjeti i transmetimit te furnizoj energji elektrike shtese ne transformatorin me te afert 110/x.

- 2.4 Pagesat e lidhjes per facilitete te reja gjenerimi te lidhura direkt me sistemin e transmetimit do te caktohen ne baze rast pas rasti dhe jane jashte qellimit te kesaj metodologjie tarifash. Pronesia e aseteve qe financohen nepermjet ketyre pagesave te lidhjes mund te transferohet tek kompania gjeneruese. Asetet e financuara nepermjet pagesave te lidhjes mund te mos perfshihen ne asetet baze te rregulluar te OST-se dhe amortizimi i ketyre aseteve fikse nuk do te mbulohet nga tarifa e transmetimit.
- 2.5 Pagesat e lidhjes per klientet e kualifikuar qe deshirojne te zoterojne transformatoret 110/x do te vendosen ne baze rast pas rasti dhe jane jashte qellimit te kesaj metodologjie tarifash. Pronesia e aseteve qe financohen nepermjet ketyre pagesave te lidhjes mund te transferohet tek klientet. Asetet e financuara nepermjet pagesave te lidhjes mund te mos perfshihen ne asetet baze te rregulluar te OST-se dhe amortizimi i ketyre aseteve fikse nuk do te mbulohet nga tarifa.
- 2.6 Tarifa e transmetimit duhet te shlyeje koston e aktiviteve te meposhtme:
- a) Pronesine, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e linjave, kablllove, nenstacioneve te transformatoreve, qendrave dispecer dhe ndertesave qe lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit
  - b) Kosto e rezervave operuese te OST-se qe nevojiten per te siguruar qendrueshmerine dhe sigurine e sistemit te transmetimit. Keto rezerva merren ne baze kontraktuale nga centralet e medha hidroenergjitike te vendosura ne Shqiperi.
  - c) Kosto e sherbimeve te tjera ndihmese te OST-se, perfshire pagesat e bera OST-ve fqinje per te siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva te castit dhe pagesat (nese ka) per frekuencen dhe rregullimin e tensionit.
  - d) Kostot e kompensimit te energjise reaktive, qe duhen alokuar ne nje pagese per energjine reaktive

- e) Kosto per te siguruar zyra, komunikim dhe facilitete te Teknologjise se Informacionit (IT) per Operatorin e Tregut plus kostot e personelit qe lidhen me Operatorin e Tregut. Nga kendveshtrimi kontabel Operatori i Tregut duhet te kete llogarite e tij, sikur te ishte nje njesi ligjore e pavarur me te ardhura te taksueshme.
- 2.7 Tarifa e transmetimit nuk duhet perdorur per te shlyer koston e importeve te energjise elektrike ose pagesat e kapacitetit qe shoqerohen me energjine e importuar ose cdo kosto tjeter te furnizuesit dhe perdoruesit te kualifikuar sipas marreveshjeve dypaleshe. Tarifa e transmetimit permban dispozita qe kerkojne rimbursimin e kostove te shkaktuara nga OST-ja gjate sigurimit te sherbimeve balancuese.
- 2.8 Rregullimi i “cmimit tavan” aplikohet per tarifen mesatare te transmetimit (me perjashtim te rimbursimeve te energjise balancuese). Rregullatori aprovon tarifen mesatare tavan te transmetimit. Nese tarifa mesatare e transmetimit e matur ne baze te te dhenave historike per nje nga vitet ne ciklin e vleresimit te tarifave e tejkalon tarifen mesatare tavan te transmetimit te vendosur nga Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike, OST-ja duhet te ule tarifat e transmetimit ne vitin vijues ne menyre qe klientet e sistemit shqiptar te transmetimit te marrin nje rimbursim te shumes se te ardhurave te teperta te mbledhura (shuma e mbi-shlyerjes).
- 2.9 Metoda “RPI-X” perdoret per t’i dhene OST-se nxitje per reduktimin e kostove te veta gjate ciklit te vleresimit te tarifave. Kohezgjatja e ciklit te shqyrtimit te tarifave te transmetimit eshte tre vjet. Nese tarifat e transmetimit per ciklin tjeter te tarifave se shqyrtuar nuk jane aprovuar ende para perfundimit te periudhes tre vjecare, rregullatori mund te miratoje nje vendim per zgjatjen e ciklit te shqyrtimit te tarifave deri ne kater vjet.
- 2.10 Caktimi i tarifave perfshin dy aktivite te nderlidhura: vendosjen e tarifave baze ekonomikisht te justifikuara per vitin baze te ciklit te shqyrtimit te tarifave dhe vendosjen e tarifave mesatare tavan te transmetimit per vitin 2 dhe 3 te ciklit te shqyrtimit te tarifave.

- 2.11 Cikli i shqyrtimit te tarifes se shperndarjes dhe cikli i shqyrtimit te tarifes se transmetimiti duhet te fillojne ne te njetjen dite te vitit (per shembull, 1 Janar ose 1 Korrik) por nuk eshte e nevojshme qe te dyja te fillojne ne te njetjen date (per shembull 1 Janar 2005).
- 2.12 Financimi afatgjate i borxhit duhet perdorur per te financuar shpenzimet e reja kapitale per aq sa eshte e mundur, por nuk duhet perdorur per te mbuluar kostot e operimit ose per te rifinancuar asetet e vjetra. OST-ja duhet te kete norme arketimi shume te larte nga klientet e sistemit te transmetimit, ne menyre qe te jete e afte te financoje shpenzimet kapitale kryesisht nepermjet huamarrjes afatgjate dhe jo fluksit te arkes pas taksave nga operimet.
- 2.13 Kompania e rregulluar do te raportoje qarte dhe pa dyshime kostot e cdo sherbimi te rregulluar perfshire vetem asetet dhe aktivitetet qe lidhen me sherbimet e rregulluara. Metoda e shperndarjes (alokimit) te kostove do te jete e kuptueshme.
- 2.14 Tarifat do t'u korrespondojne kostove qe do te krijohen nga nje kompani transmetimi e miremenaxhuar qe mundohet te beje investime te kujdesshme, te minimizojte humbjet ne rrjet dhe te shmange shpenzimet e kota. Kur vendoset tarifa baze rregullatori ka te drejte te hetoje nivelet e kosos te raportuara nga OST-ja dhe te krahasoje kostot e saj njesi me te OST-ve te tjera.
- 2.15 Rregullatori nuk ka te drejte te perjashtojte nga llogaritja e tarifave koston e investimeve qe do te ishte bere nga nje kompani transmetimi e mire menaxhuar ne baze te informacionit te disponueshem per kompanine kur eshte marre vendimi i investimit.
- 2.16 Ne pergatitjen e aplikimit per tarifa OST-ja do te perpiqet te paraqese gjithë kostot me saktesi deri ne 10,000 leke. Rregullatori nuk duhet t'i diskutoje shifrat me te vogla se 10, 000 leke pervec kur ka nje mosmarreveshje mbi kompensimin ose pagesen per persona te vecante fizike.

### **3. Energjia elektrike dhe bilancet e energjise elektrike**

- 3.1 Bilanci i energjise elektrike te OST-se per vitin baze do te pergatitet nepermjet perlllogaritjes se shumes totale te energjise ne GWh te marre nga rrjeti i transmetimit gjate

vitit baze. Ky total eshte i barabarte me energjine e marre nga centralet gjeneruese shqiptare te lidhur me rrjetin e transmetimit plus energjine e marre nga rrjetet e transmetimit te vendeve fqinje. Energjia totale e marre duhet te ndahet ne:

- a) energji elektrike e livruar ne rrjetet shqiptare te shperndarjes
- b) energji elektrike e livruar tek perdoruesit e kualifikuar te lidhur me sistemin e transmetimit
- c) tranzitet ose flukset e pakontrolluara
- d) energji elektrike e livruar ne stacionet e pompimit te rezervave hidroenergjitike (nese ka)
- e) humbjet e energjise elektrike ne rrjetin e transmetimit (perjashtuar humbjet ne transformatoret 110/x ne pronesi te kompanive te shperndarjes dhe klienteve te medhenj)
- f) konsumi i energjise elektrike nga OST-ja per qellime teknologjike.

3.2 Bilanci koincidues i pikut te fluksit te ngarkeses se OST-se do te pergatitet duke perlllogaritur energjine elektrike totale ne MW te marre nga rrjeti i transmetimit ne oren e pikut. Ky total eshte i barabarte me energjine elektrike te marre nga centralet shqiptare te gjenerimit te lidhur me rrjetin e transmetimit plus energjine elektrike te marre nga rrjetet e transmetimit te vendeve fqinje. Energjia totale e marre duhet ndare ne:

- a) energji elektrike e livruar ne rrjetet shqiptare te shperndarjes
- b) energji elektrike e livruar tek perdoruesit e kualifikuar te lidhur me sistemin e transmetimit
- c) tranzitet ose flukset e pakontrolluar (loop flows)
- d) energji elektrike e livruar ne stacionet e pompimit te rezervave hidroenergjitike (nese ka)<sup>1</sup>
- e) humbjet elektrike e energjise ne rrjetin e transmetimit (perjashtuar humbjet ne transformatoret 110/x ne pronesi te kompanive te shperndarjes dhe klienteve te medhenj)
- f) konsumi i energjise elektrike nga OST-ja per qellime teknologjike.

---

<sup>1</sup> Kjo vlere duhet te jete e barabarte me zero, pervec kur ka nje zone me teprice prodhimi te hidroenergjise lidhur me ngarkesen dhe rrjeti i transmetimit eshte i demtuar dhe per kete arsye zona eshte e izoluar.



- 3.3 Bilancet e energjise elektrike dhe fuqise per te gjithë rrjetin shqiptar te transmetimit dhe shperndarjes nuk jane nje zevendesues i pranueshem per bilancet e sistemit te transmetimit.
- 3.4 Energjia elektrike vjetore e shoqeruar me tranzitet dhe flukset e pakontrolluara duhet ilustruar me nje diagrame qe tregon se cilat vende kane livruar energji elektrike ne Shqiperi dhe cilat vende kane marre energji nga Shqiperia. Fluksi pik i fuqise i shoqeruar me tranzite dhe flukse te pakontrolluar duhet ilustruar me nje diagrame te fluksit te ngarkeses, qe tregon se cilat vende kane livruar energji elektrike ne Shqiperi dhe cilat vende kane marre energji elektrike nga Shqiperia.
- 3.5 Nese tranzitet dhe flukset e pakontrolluara jane me shume se 1 perqind e fluksit te ngarkeses ne rrjetin e transmetimit gjate ores pik vjetore koiciduese, OST-ja duhet te tregoje nese kapaciteti i ri i rrjetit te transmetimit ne Shqiperi eshte ndertuar per t'u sherbyer vendeve fqinje dhe duhet te shpjegoje nese OST-ja merr kompensim te mjaftueshem per sigurimin e kapacitetit te fluksit te ngarkeses pik ne vendet fqinje.
- 3.6 Per secilin nga dhjete vitet e fundit, humbjet e energjise elektrike ne rrjetin e transmetimit duhen treguar si nje perqindje e energjise se marre nga rrjeti i transmetimit.
- 3.7 Nese ekziston ndonje import, eksport dhe tranzit i rendesishem i energjise elektrike nepermjet sistemit shqiptar te shperndarjes ne vend te sistemit te transmetimit, kjo duhet raportuar ne aplikimet per tarifat e transmetimit. Gjeneratoret hidroelektrike te vendosur prane kufirit te Shqiperise nuk duhen lejuar te ndertojne linja direkte me vendet e tjera per te eksportuar energji elektrike nepermjet linjave direkte.
- 3.8 Energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-se me tension te ulet ose mesatar dhe te livruar nepermjet rrjetit te shperndarjes duhet perfshire ne shumen totale te energjise se livruar ne rrjetin e shperndarjes. OST-ja mund te bleje energji me tension te ulet ose te mesem sipas tarifes per institucionet buxhetore.
- 3.9 Gjate nje periudhe tranzitore mund te jete e nevojshme qe OST-ja te vleresoje disa vlera per shkak te mungeses se matesve. OST-ja duhet te synoje te kete nje mates ne cdo pike ku asetet ne pronesi te OST-se jane te lidhura me asetet ne pronesi te klientit te sistemit te transmetimit. Per shembull, fluksi i energjise elektrike nga nje linje 110 kV ne nje

transformator 110/x ne pronesi te kompanise shperndarese ose te nje klienti te madh industrial duhet matur ne anen 110 kV te transformatorit.

#### 4. Kostot qe duhen perfshire ne llogaritjen e tarifave

- 4.1 Kostot qe duhen perfshire ne llogaritjen e tarifave shlyhen nepermjet pagesave qe lidhen me kapacitetin, pagesave qe lidhen me energjine dhe pagesave fikse mujore qe konsistojne ne kostot e kapitalit, kostot operative dhe taksat. Vetem kostot ekonomikisht te justifikuara qe lidhen me dispoziten e sherbimeve te rregulluara do te perfshihen ne llogaritjen e tarifave. Niveli i synuar i te ardhurave qe do te mblidhen gjate vitit baze eshte i barabarte me:

$$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}} + C_{\text{takse}}$$

- 4.2 TVSH-ja nuk eshte perfshire ne formulen e treguar me lart sepse eshte llogaritur nga OST-ja per cdo fature mujore te klientit te sistemit te transmetimit per sherbimin e transmetimit, dhe eshte treguar si nje ze i vecante ne faturen mujore.
- 4.3 Kostot e energjise elektrike reaktive te OST-se duhen shlyer nepermjet nje pagese te vecante te energjise elektrike reaktive te matur ne leke/kvarh, qe do te tregohet ne faturat mujore te OST-se per kompanite e shperndarjes dhe klientet e kualifikuar te lidhur direkt me sistemin e transmetimit.
- 4.4 Kostot kapitale eshte e barabarte me kthimin e kapitalit, plus amortizimin.

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

$C_{\text{kapital}}$  – komponenti i lidhur me kapitalin i te ardhurave te synuara per vitin baze

$R$  – kthimi i kapitalit

$D$  – amortizimi i asetave fikse dhe amortizimi i asetave te tjera

- 4.4.1 Kthimi i kapitalit eshte llogaritur me formulen:

$$R = B * r$$

**B** - Aseti Baze i Rregulluar ne fillim te vitit baze te ciklit te vleresimit te tarifave

**r** - norma e lejueshme e kthimit te Asetit Baze te Rregulluar.

4.4.2 Vlera e asetit baze te rregulluar duhet te jete e barabarte me koston e zevendesimit te aseteve fikse te perdorura per te siguruar sherbim transmetimi, minus amortizimin, minus nje rregullim per vjeterimin ekonomik. Rregullatori ka te drejte t'i kerkoje OST-se qe te punesoje nje firme audituese ose nje ekspert te vleresimit te aseteve per te kryer nje studim per vleresimin e aseteve, nese nje studim i tille nuk eshte kryer per te pakten pese vjet. Rregullatori do te supozoje se kosto e zevendesimit e cdo asetit me pak se pese vjecar eshte e barabarte me koston aktuale te bere, pervec kur rregullatori ka arsye per te besuar se OST-ja ka bere kosto te tepruara ne projektet e tij te fundit te ndertimit.

4.4.3 Trualli dhe e drejta e kalimit te perdorura nga OST-ja mund te vleresohen me koston fillestare te blerjes te rregulluar per inflacionin. Nuk eshte e nevojshme te vleresohet vlera e tregut te ketij trualli.

4.4.4 Amortizimi i kategorive te ndryshme te aseteve do te bazohet mbi jeten operuese te pritshme te ketyre aseteve. Nese te dhenat financiare jane shtremberuar nga perdorimi i shifrave shume te larta per jetegjatesine e amortizimit, rregullatori mund ta instruktoj OST-ne qe te pergatise nje pakete llogarish financiare per qelimin e berjes se tarifave, duke perdorur jetegjatesine e amortizimit te aprovuar nga rregullatori.

4.4.5 Asnje nga asetet e OST-se nuk duhet konsideruar si aset "stranded" (me vlere te regjistruar me te larte se vlera e tregut). Nese vleresohen sipas koston se amortizuar te zevendesimit dhe jane ne operim, atehere eshte e arsyeshme te supozohet se nevojiten per te siguruar sherbim transmetimi ne nje treg konkurrues te energjise elektrike ne Europen Juglindore.

4.4.6 Norma e lejueshme e kthimit ne Asetin Baze te Rregulluar eshte llogaritur nga nje norme e lejueshme kthimi e kapitalit ne vitin baze, nje norme mesatare e perlllogaritur e interesit mbi

borxhin afatgjate gjate vitit baze, dhe nje raport borxh/kapital i vet. Te treja keto vlera duhen dhene ne vendimin per tarifate te nxjerre nga rregullatori ne menyre qe supozimet e perdorura per te llogaritur normen e lejueshme te kthimit te paraqiten qarte. Norma e lejueshme e kthimit per Asetin Baze te Rregulluar eshte:

$$r = roe \times (1 - d) + i \times d$$

**roe** - norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin pas takses; nje tregues i vendosur nga rregullatori

**d** - norma e borxhit – si norma e borxhit afatgjate per asetet afatgjate – qe vendoset nga rregullatori dhe aplikohet per Asetin Baze te Rregulluar

**i** - norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjate

4.4.7 Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet zgjedhur nga rregullatori mbi bazen e nevojese OST-se per te marre fluksin e parave per shpenzime kapitale sic tregohet ne deklaraten e burimeve dhe perdorimet e fondeve ne vitin baze. Gjithe fitimet duhen perdorur per te mbeshtetur programin e shpenzimeve kapitale te OST-se dhe per te rritur vleren e kontabilizuar te pjeses se kapitalit. OST-ja mund te mos i paguaje dividente aksionerit te saj, Ministrise se Ekonomise se Shqiperise.

4.4.8 Nese OST-ja mund te demonstroje se ka nje nevoje urgjente per shpenzime kapitale specifike dhe se financimi i borxhit per keto asete nuk disponohet, ERE-ja mund te vendose te caktojte nje norme te larte te lejueshme te kthimit te kapitalit dhe ta mundesoje ne kete menyre OST-ne qe te gjenerojte fluksin shtese te parave qe nevojiten. Megjithate, ERE-ja pranon se kjo metode do te rrise taksat per t'u paguar te OST-se dhe prandaj nuk eshte nje metode e thjeshte per financimin e shpenzimeve kapitale; eshte gjithashtu nje metode per rritjen e te ardhurave te qeverise nga taksat. Vendimi i marre nga rregullatori duhet bazuar ne interesat e klienteve dhe jo ne nevojen e Qeverise per te ardhura nga taksat.

4.4.9 Norma mesatare e ponderuar e interesit mbi borxhin afatgjate duhet percaktuar si (a) shuma e pagesave te interesit mbi borxhin afatgjate gjate vitit baze, pjestuar me principalin total

mbi borxhin afatgjate (shuma totale e marre borxh) ne fillim te vitit baze ose (b) shuma e pagesave te interesit mbi borxhin afatgjate gjate ciklit 3 vjecar te shqyrtimit te tarifave pjestuar me shumen e sasise se marre borxh ne fillim te vitit baze, shumen e marre borxh ne fillim te vitit 2, dhe shumen e marre borxh ne fillim te vitit 3. Nese rregullatori nuk gjen nje arsye per te besuar se OST-ja ka marre para borxh me perqindje interesi me te larta se sa duhet per te marre financim per OST-ne, OST-ja duhet te llogarise normen mesatare te ponderuar te interesit mbi borxhin afatgjate dhe ta tregojte ne aplikimin e tarifes.

4.4.10 Para dorezimit te aplikimit te tarifave, OST-ja mund te paraqese nje aplikim per rregullatorin per vendosjen e normes se lejueshme te kthimit mbi Asetin Baze te Rregulluar. Rregullatori duhet t'i pergjigjet ketij aplikimi sipas procedurave te miratuara per aplikimin e tarifave.

4.4.11 Gjithe perberesit kryesore te sistemit te transmetimit duhet te jene pronesi e OST-se dhe jo te meren me qera. Pagesat qe shoqerohen per qera (per shembull, dhentia me qera e mjeteve te motorizuara) do te perfshihen ne shpenzimet operuese.

4.4.12 Kostot qe shoqerohen me blerjen e aseteve te patrupezuara te tilla si patentat, licencat, markat, licencat software dhe informacionet e marra nepermjet kerkimeve dhe zhvillimeve duhen treguar si shpenzime operimi. Per llogaritjen e tarifes se transmetimit nuk ka arsye te kapitalizohet vlere e aseteve te paprekshme.

4.5 Kostot operuese te OST-se perfshijne:

$$C_{\text{operuese}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirembajtje}} + C_{\text{rrogat}} + C_{\text{humbjet}} + C_{\text{tek}} + C_{\text{jashteburimore}}$$

$C_{\text{matjes}}$  - kosto e matjes se energjise elektrike dhe energjise se livruar tek klientet e sistemit te transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve te llogarive me klientet e sistemit te transmetimit<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Kjo kategori mat kostot qe lidhen me klientet dhe nuk perfshin koston e matjes se humbjeve te energjise elektrike, konsumin e energjise elektrike per qellime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Qellimi i matjes se  $C_{\text{matjes}}$  eshte llogaritja e pageses mujore fikse per cdo klient te sistemit te transmetimit te bazuar ne numrin e pikave ku klienti eshte i lidhur me sistemin e transmetimit.

$C_{\text{mirembajtje}}$  - pjese zevendesimi, furnizime, mjete, lende djegese dhe kosto te tjera mirembajtje; ky komponent perjashton kostot e mirembajtjes qe i jane caktuar  $C_{\text{matjes}}$

$C_{\text{rrogat}}$  - pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore dhe kostot (te ndryshme nga taksat) te lidhura me programet ne perfitim te te punesuarve; ky komponent perjashton kostot e pagave qe i jane caktuar  $C_{\text{matese}}$

$C_{\text{humbjet}}$  - nje pagese per koston e vertete ekonomike te gjithe humbjeve te energjise elektrike ne rrjetin e transmetimit, perfshire humbjet qe lidhen me eksportin dhe tranzitin

$C_{\text{tek}}$  - nje pagese per koston e vertete ekonomike te konsumit te energjise per qellime teknologjike; kjo eshte e ngjashme me pagesen per humbjet ne rrjet

$C_{\text{jashteburimore}}$  - shpenzimet per sherbimet profesionale qe perfshijne kontabilitetin, juristet, keshilltaret financiare, konsulentet, specialistet IT, dhe agjensite e reklamave (perjashtuar shpenzimet qe jane perfshire tashme ne paga)

4.5.1 Kostot qe lidhen me operimin e qendres dispecer duhen perfshire ne kategorite e treguara me lart. Kostot e dispecerimit nuk ka nevojte te tregohen me vete.

4.5.2 Ne llogaritjen e tarifes se transmetimit, cmimi i caktuar per humbjet e rrjetit te transmetimit nuk percaktohet nga KESH-i ose deget e tij dhe nuk varet nga kontratat mes OST-se dhe KESH-it. Ne te vertete, eshte nje vleresim qe vjen nga tregu rajonal i energjise elektrike te Europes Juglindore:

$$C_{\text{humbje}} = E_{\text{humbje}} * P_{\text{rajonale}}$$

$E_{\text{humbje}}$  - humbjet e energjise ne rrjetin e transmetimit gjate vitit baze

$P_{\text{rajonale}}$  - cmimi mesatar i energjise elektrike qe do te importohet nga tregu rajonal i energjise elektrike te Europes Juglindore gjate vitit baze.

4.5.3 Ne aplikimin per tarifa, OST-ja duhet te siguroje nje perlllogaritje te vleres se  $P_{\text{rajonale}}$ . Nje metode per perlllogaritjen e kesaj vlere eshte llogaritja e cmimit mesatar te importeve dhe eksporteve te energjise elektrike gjate vitit baze, bazuar ne cmimet orare dhe ne nje mase te njejte per cdo ore te vitit. Nje metode tjeter per perlllogaritjen e kesaj vlere eshte drejtimi i nje tenderi konkurrues per 10 MW energji qe do te importohet cdo ore nga Operatori i Tregut.<sup>3</sup> Nje metode tjeter do te ishte llogaritja e cmimit mesatar vjetor te energjise se ngarkeses baze ne shkembimin e energjise ne Slloveni dhe pastaj rregullimi i kesaj vlere ne baze te nje perlllogaritje te diferences mes cmimit mesatar ne Slloveni dhe cmimit mesatar ne kufirin shqiptar. ERE-ja do te zgjedhe metoden me te mire.

4.5.4 I njejti cmim  $P_{\text{rajonale}}$  eshte perdorur per te matur koston vjetore te konsumit te energjise elektrike per qellime teknologjike:

$$C_{\text{tek}} = E_{\text{tek}} * P_{\text{rajonale}}$$

$E_{\text{tek}}$  - konsumi i energjise elektrike per qellime teknologjike gjate vitit baze

4.5.5 Ne aplikimin per tarifa OST-ja mund te paraqese nje propozim per te caktuar cmime pervec  $P_{\text{rajonale}}$  ne humbjet ne rrjet dhe per konsumin e energjise per qellime teknologjike. Megjithate, OST-ja mund te mos propozoje asnje cmim qe mund te manipulohet nga KESH-i dhe mund te mos e perdori kete ceshtje cmimesh per te vonuar ose shtyre programin per shqyrtimin dhe miratimin e tarifave te transmetimit.

4.5.6 Ne rrethana te vecanta, riparimi dhe mirembajtja e sistemit te transmetimit mund te behet nga firmat private dhe jo nga punonjesit e OST-se. Pas nje furtune te madhe, per shembull, mund te kontraktohet me firma private per pune riparuese qe nevojiten urgjent. Kostot duhen perfshire ne  $C_{\text{jashteburimore}}$ .

4.6 Komponenti  $C_{\text{taksa}}$  mundeson qe rregullatori te tregojte qarte pjesen e tarifes qe i atribuohet taksave dhe prandaj eshte pertej kontrollit te rregullatorit.<sup>4</sup> Megjithese eshte e mundur qe

---

<sup>3</sup> Ko energji mund te shitet tek klientet shqiptare, furnizuesit shqiptare ose te klientet dhe furnizuesit e vendosur ne vendet fqinje.

<sup>4</sup> Sipas standarteve financiare nderkombetare, taksat qe lidhen me rrogat dhe taksat e pronesis normalisht perfshihen ne shpenzimet operuese dhe taksat mi fitimin perfshihen ne te ardhurat para taksave dhe prandaj shoqerohen me kthimin e kapitalit.

tarifat e energjië elektrike te reduktohen duke ulur kontributin e sektorit elektrik ne te ardhurat nga taksat, roli i rregullatorit eshte thjesht sigurimi i shifrave qe tregojne komponentin takse te tarifave te sektorit elektrik perfshire tarifen e transmetimit. Komponenti takse i te ardhurave te synuara te OST-se per vitin baze, perjashtuar TVSH-ne, eshte:

$$C_{\text{takse}} = C_{\text{taksa sociale}} + C_{\text{taksa pronesie}} + C_{\text{takse fitimi}} + C_{\text{ERE}}$$

- 4.6.1 Komponenti takse i emeruar  $C_{\text{taksa sociale}}$  perfshin gjithe taksat qe lidhen me pagat si taksat e pensionit. Ai perfshin taksat qe lidhen me te ardhurat qe perdoren nga qeveria per te siguruar perfitime papunesie dhe trajnim per punetoret qe humbasin punen. Sigurimet e blera nga OST-ja konsiderohen pjese e shpenzimeve operuese dhe jo pjese e taksave sociale edhe nese kjo kerkohet nga rregulloret e Keshillit te Ministrave.
- 4.6.2 Komponenti i kostos i emeruar  $C_{\text{taksa pronesie}}$  perfshin gjithe taksat pervec taksave sociale, taksat mbi te ardhurat dhe TVSH-ne. Per shembull ky komponent perfshin pagesat e vendosura nga autoritetet qeveritare pervec ERE-s per leje dhe licenca. Taksa e pronesise mbi ndertesat, ndertimet dhe truallin ne pronesi te OST-se llogaritet bazuar ne aktet ligjore te Republikes se Shqiperise.
- 4.6.3 Komponenti i kostos  $C_{\text{takse fitimi}}$  perfshin gjithe taksat e fitimit te paguara nga OST-ja Qeverise Shqiptare. Per vitin baze, ky komponent mund te perfshije nje pagese per taksat e paguara ne vitin 2 dhe vitet e mevonshme, por qe i atribuohet fitimit pas taksave te arritur ne vitin baze.
- 4.6.4 Komponenti i kostos  $C_{\text{ERE}}$  perfshin gjithe pagesat rregulluese te paguara ERE-s nga OST-ja.
- 4.6.5 OST-ja nuk duhet te mbledhe te ardhura per qellimin e mbulimit te detyrimeve tatimore te KESH-it. Tarifa e transmetimit nuk duhet te permbaje asnje komponent qe lidhet me detyrimet tatimore te KESH-it para se OST-ja te niste operimet.

## 5. Ndarja e kostove ne kapacitet, energji dhe pagesa fikse mujore



- 5.1 Cdo klient i sistemit te transmetimit duhet te paguaje nje pagese kapaciteti ne leke/kW/Muaj, te bazuar ne ngarkesen pik te klientit gjate periudhes 12 mujore qe mbaron ne muajin e faturimit. Nese klienti ka nenshkruar nje marreveshje me OST-ne ku klienti duhet te paguaje per nje shume specifike te kapacitetit te garantuar nga marreveshja, atehere aplikohet pagesa e kapacitetit per ate qe eshte me e larte – kapaciteti kontraktual i garantuar, ose ngarkesa pik e klientit gjate periudhes 12 mujore qe mbaron me muajin e faturimit.
- 5.2 Cdo klient i sistemit te transmetimit duhet te paguaje nje pagese per energjine ne leke/kWh, bazuar ne sasine e kWh te livruar nga sistemi i transmetimit tek klienti i sistemit te transmetimit gjate atij muaji.
- 5.3 Cdo klient i sistemit te transmetimit duhet te paguaje nje pagese mujore fikse qe synon te mbuloje matjen, faturimin dhe kostot e likuidimit te OST-se per te siguruar sherbim per ate klient gjate vitit baze.
- 5.4 Ne aplikimin per tarifa OST-ja duhet te siguroje nje parashikim te:
- a) kapacitetit total ne kW qe do tregohet ne faturen e klientit te sistemit te transmetimit ne cdo muaj te vitit baze dhe shumen e ketyre totaleve mujore
  - b) energjine totale ne kWh qe do tregohet ne faturat e klientit te sistemit te transmetimit ne cdo muaj te vitit baze dhe shumen e ketyre totaleve mujore
  - c) numrin e pikave te livrimit tek klientet e sistemit te transmetimit ne fillim te vitit baze dhe numrin e pikave te livrimit ne fund te vitit baze dhe mesataren e ketyre dy shifrave
- 5.5 Te ardhurat totale te mbledhura nepermjet pagesave te kapacitetit ne vitin baze jane te barabarta me:

$$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} + C_{\text{takse fitimi}}$$

- 5.6 Pagesa e kapacitetit ne leke per kWh ne muaj eshte e barabarte me:

$$P_{kapacitet} = C_{kapacitet} \div L$$

**L** - shuma e kapacitetit total mujor e treguar ne faturat e klientit te sistemit te transmetimit, gjate 12 muajve te vitit baze

5.7 Te ardhurat totale te mbledhura nepermjet pagesave te energjise ne vitin baze jane te barabarta me:

$$C_{energji} = C_{mirembajtje} + C_{paga} + C_{humbje} + C_{tek} + C_{jashteburimore} + C_{taksa\ sociale} + C_{takse\ pronesie} + C_{takse\ fitimi} + C_{ERE}$$

5.8 Pagesa e energjise ne leke per kWh eshte e barabarte me:

$$P_{energji} = C_{energji} / E$$

**E** - energjia totale ne kWh qe do tregohet ne faturat e klientit te sistemit te transmetimit gjate vitit baze

5.9 Te ardhurat totale qe do te mblidhen nepermjet pagesave fikse mujore ne vitin baze jane te barabarta me  $C_{matjes}$

5.10 Pagesa mujore fikse ne leke per pike livrimi eshte e barabarte me:

$$P_{mujore} = C_{matjes} / N$$

**N** - mesatarja e numrit te pikave te livrimit tek klientet e sistemit te transmetimit ne fillim te vitit baze dhe te pikave te livrimit ne fund te vitit baze.

## 6. Llogaritja e tarifes mesatare te transmetimit

6.1 Ne cdo vit te ciklit te shqyrtimit te tarifes, tarifa mesatare e transmetimit eshte e barabarte me:

$$P_{\text{mesatare}} = (C_{\text{kapacitetit}} + C_{\text{energji}} + C_{\text{matjes}}) / E$$

$P_{\text{mesatare}}$  - tarifa mesatare e transmetimit

- 6.2 Tarifa mesatare e transmetimit reflekton koston e pronesisë, ndertimit, operimit dhe mirembajtjes së linjave, kablove, nenstacioneve të transformatoreve, qendrave dispecer dhe ndertesave që lidhen me to dhe facilitetet e komunikimit. Nuk reflekton koston e gjithë aktiviteteve të tjera të renditura në paragrafin 2.6, sepse ato kosto duhen shlyer nga OST-ja nëpërmjet pagesave shtese. Për shembull, koston që lidhen me pagesat e energji elektrike reaktive përjashtohen nga tarifa mesatare e transmetimit.
- 6.3 Tarifa mesatare e transmetimit mund të llogaritet për një periudhë 12 mujore. Te dhënat mujore mund të jenë parashikim ose kombinim i te dhënave të parashikuara për muajt e ardhshëm dhe të dhëna të vlerësuara për muajt e fundit.

## **7. Komponenti i transmetimit të tarifave të klienteve tarifore**

- 7.1 Në aplikimin e tarifave OST-ja duhet të paraqesë për çdo furnizues të kompanisë së shpërndarjes, një përlogaritje të të ardhurave totale të OST-së që duhen mbledhur nga ai furnizues gjatë vitit baze nëpërmjet pagesave të kapacitetit, pagesave të energji dhe pagesave të matjes.
- 7.2 Është përgjegjësi e furnizuesit të kompanisë së shpërndarjes që të përgatisë një aplikim tarife në të cilin të ardhurat totale të OST-së për atë kompani shpërndarje të mbledhen nga klientët tarifore dhe të kualifikuar në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Grupet e krahasueshme të klienteve tarifore dhe të kualifikuar të lidhur me sistemin e shpërndarjes duhet të paguajnë direkt ose indirekt, të njëjtat pagesa transmetimi.
- 7.3 Në metodologjinë e tarifave të klienteve tarifore dhe në metodologjinë e tarifave të përdorimit të rrjetit të sistemit shpërndarës, pagesat e kapacitetit që furnizuesi i kompanisë së shpërndarjes i paguan OST-së duhen ndare mes grupeve të klienteve të lidhur me sistemin e shpërndarjes, sipas kontributit të çdo grupi në ngarkesën koinkiduese pikë të kompanisë shpërndarëse. Kjo llogaritje duhet të marrë në konsideratë humbjet teknike në

nivele te ndryshme tensioni si dhe faktorin e ngarkeses vjetore dhe ngarkesen vjetore pik ne kW te cdo grupi klientesh.

- 7.4 Nese aplikohet pagesa e energjise se OST-se per konsumin e energjise elektrike ne kWh te treguar ne faturat e klienteve me tension te mesem dhe te ulet, te ardhurat totale do te jene me pak se shuma e pagesave te energjise elektrike te paguara nga kompania e shperndarjes OST-se, qe perfshin pagesat e energjise te shoqeruara me humbjet ne rrjetin e shperndarjes. Nese pagesa e kapacitetit te OST-se aplikohet per ngarkesen pik ne kW te treguar ne faturat e klienteve ose te vleresuara per grupet e klienteve, te ardhurat totale ka te ngjare te jene me te medha se sa shuma e pagesave te kapacitetit te paguara nga kompania e shperndarjes OST-se, sepse do te kete nje fare diversiteti mes ngarkesave pik. Prandaj, mund te perfshihet pagesa e energjise se OST-se dhe pagesa e kapacitetit te OST-se ne tarifen e klienteve tarifore dhe te arketohet shuma “korrekte” e te ardhurave. Kjo eshte nje menyre shume e thjeshte per te vendosur komponentin e transmetimit te tarifave te klienteve tarifore, dhe do te ishte e pranueshme per ERE-n me kusht qe kompania e shperndarjes te shlyeje as me shume dhe as me pak se koston e vet totale te sherbimit te transmetimit nepermjet ketyre komponenteve te energjise dhe kapacitetit te tarifes se saj.
- 7.5 OST-ja duhet te shqyrtoje aplikimet per tarifa te paraqitura nga furnizuesit e kompanise se shperndarjes, per te siguruar se te ardhurat totale te OST-se per ate kompani shperndarjes jane arketuar nga klientet e kompanise se shperndarjes ne menyre transparente dhe jo-diskriminuese. OST-ja duhet t’i dergoje nje leter ERE-s ku te tregojte nese kostot e sistemit te transmetimit i jane ngarkuar klienteve tarifore ne menyre transparente dhe jo-diskriminuese. Opinioni i OST-se do te merret ne konsiderate nga ERE-ja ne shqyrtimin e tarifave te propozuara per klientet tarifore.

## **8. Vendosja e tarifave mesatare tavan te transmetimit**

- 8.1 Per vitin baze, tarifa mesatare e transmetimit eshte e barabarte me tarifen mesatare te transmetimit te llogaritur sipas koston ne vitin baze.
- 8.2 Per vitin e dyte te ciklit te vleresimit te tarifave (Viti 2), tarifa mesatare e transmetimit per vitin baze shumezohet me faktorin vjetor te rregullimit:

$$A = (1 + RPI - X)$$

**A** - faktori i axhustimit vjetor

**RPI** - norma e inflacionit per cmimet e konsumit e parashikuar per Vitin e 2-te nga Banka Kombetare Shqiptare, ose e vendosur nga ERE-ja ne baze te prirjes se indeksit te cmimit te konsumatorit gjate periudhes se 3 viteve te fundit per te cilet disponohen te dhena historike

**X** - faktori i permiresimit te eficences i percaktuar nga ERE-ja

- 8.3 ERE-ja sipas gjykimit te saj, mund t'i shtoje kesaj formule nje faktor te permiresimit te aktivitetit te bazuar ne cilesine e furnizimit tek klientet e sistemit te transmetimit ne 110 kV ose ne nivelin e humbjeve te energjise elektrike ne rrjetin e transmetimit. Ky faktor i permiresimit te aktivitetit duhet percaktuar shume qarte dhe thjesht dhe OST-ja duhet ta siguroje ERE-n se eshte e afte te siguroje cilesine e te dhenave te furnizimit qe nevojiten per te matur me saktesi permiresimin e aktivitetit.
- 8.4 Vlera e X-it duhet percaktuar ne baze te studimit te standarteve te operatoreve te sistemit te transmetimit ku shqyrtohet aktiviteti i te pakten 3 OST-ve te rajonit, gjate nje periudhe prej te pakten 3 vjetesh. Nese ERE-ja nuk ka kohe te drejtoje nje studim te tille standartesh ose te vleresojte rezultatet e studimeve te tjera te standarteve, atehere vlera e X-it duhet te jete zero.
- 8.5 Nese aktiviteti aktual financiar i OST-se ne cdo vit te ciklit te vleresimit te tarifave eshte me i mire nga sa tregojne parashikimet financiare te aplikimit te tarifave ose me mire nga sa e priste ERE, mund te jepen bonuse per menaxheret e larte dhe punonjesit e OST-se pa ngritur tarifen mesatare te transmetimit mbi tarifen mesatare tavan te transmetimit. Prandaj OST-ja ka nje nxitje per te permiresuar eficencen dhe per te reduktuar kostot, edhe kur vlera e X-it eshte zero
- 8.6 Per vitin e trete te ciklit te shqyrtimit te tarifave (Viti 3), tarifa mesatare e transmetimit per vitin e dyte shumezohet me faktorin vjetor te axhustimit duke perdorur vleren RPI qe i korrespondon Viti 3.

- 8.7 Per vitin e katert te ciklit te shqyrtimit te tarifave (Viti 4), tarifa mesatare e transmetimit per vitin e trete shumezohet me faktorin vjetor te axhustimit, duke perdorur nje vlere RPI qe i korrespondon Vitit 4. Nese tarifate e transmetimit per ciklin tjetere te korrjimit te tarifave jane miratuar para mbarimit te periudhes trevjecare atehere nuk do te jete nevoja te llogaritet tarifa mesatare e transmetimit per Vitin 4.
- 8.8 Mbi-kthimi i te ardhurave i duhet rimbursuar klienteve te sistemit te transmetimit nepermjet axhustimit ne nivelin e pageses se energjise ne tarifen e transmetimit. Nuk ka nevojte te rregullohet pagesa e kapacitetit ose pagesa mujore fikse.
- 8.9 OST-ja nuk duhet “ndeshkuar” kurre per mbi-kthimin e te ardhurave, nepermjet rregullimit te normes se lejueshme te kthimit te kapitalit ose nepermjet rregullimit te cmimit  $P_{\text{rajonale}}$  qe eshte caktuar per humbjet ne rrjet dhe per konsumin e energjise elektrike per qellime teknologjike. Mbi-kthimi i te ardhurave mund te rezultoje nga gabime ne parashikim dhe nga ngjarje dhe prirje te papritura ne sektorin e energjise elektrike.
- 8.10 Mbi-kthimi i te ardhurave gjate vitit te fundit te ciklit te shqyrtimit te tarifave u duhet rimbursuar klienteve te sistemit te transmetimit nepermjet axhustimit ne nivelin e pageses se energjise ne vitin baze te ciklit pasues te axhustimit te tarifave.
- 8.11 Ne rast se nje ngjarje e “forces madhore” crregullon sistemin e transmetimit, OST-ja mund t’i paraqese ne cdo kohe ERE-s nje kerkese per leje per te axhustuar pagesen e energjise ne tarifen e transmetimit ne menyre qe OST-ja te arketoje nje shume specifike shtese te ardhurash. Megjithate, rritja e tarifes se transmetimit nuk do te siguroje te ardhura te rendesishme per sektorin e energjise elektrike nese nuk rritet tarifa per klientet tarifore. OST-ja duhet te synoje te arrije tarifa transmetimi te qendrueshme dhe te parashikueshme.

## **9. Procedurat e aplikimit per tarifate e transmetimit te energjise elektrike**

- 9.1 Paraqitja e kerkeses per miratimin e tarifave te reja ose ndryshimin e tarifave ekzistuese do te filloje nga:
- a) Nje paraqitje formale te kerkeses per miratimin e tarifave te reja ne ERE nga Operatori i Sistemit te Transmetimit. Kjo kerkese do te paraqitet prane ERE-s jo me pak se 6 (gjashte

muaj) perpara nga dita ne te cilen kerkohen te hyne ne fuqi tarifat e reja te propozuara nga OST;

- b) Nje shqyrtim paraprak nga ana e ERE-s i kerkeses formale te paraqitur sipas paragrafit (9.1.1) dhe njoftimi i OST brenda 30 (tridhjetë) diteve kalendarike, per marrjen ose jo ne shqyrtim nga ana e ERE-s, te aplikimit per tarifat e propozuara.

Te gjitha paraqitjet e kerkesave per miratimn e tarifave te behen ne perputhje me piken 9.2.

Per tre vitet e para te funksionimit te OST-se rishikimi i cmimit nga ERE do te behet cdo vit.

